

URDHËR
Nr. 7, datë 17.2.2021

**MBI MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCEDURAVE TË
PËRQENDRUARA TË PROKURIMIT PUBLIK PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR
INSTITUTI I SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si rezultat i mungesës së kapaciteteve në institucionet e varësisë për realizimin me sukses të procedurave,

UDHËZOJ:

1. Realizimin e procedurave, ku impakti i tyre është me një risk të lartë, me vlerë mbi 800,000 (tetë qind mijë) lekë pa TVSH, në mënyrë të përqendruar, për autoritetin kontraktor, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural merr përsipër rolin e Organit Qendror Blerës për zhvillimin e procedurave të prokurimit në emër dhe për llogari të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për kryerjen e të gjithë procedurave të prokurimit, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, që nga njoftimi i kontratës e deri te publikimi i njoftimit të nënshkrimit të kontratës në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

4. Pas njoftimit të fituesit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dërgon pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, dokumentacionin e plotë, në formë të shkruar, për të vijuar me nënshkrimin e kontratës përkatëse.

5. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin e kontratës.

6. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë duhet të dërgojë pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, jo më vonë se data 1.3.2021, dokumentacionin e plotë (në formë shkresore dhe elektronike), termat e referencës, specifikimet teknike, fondin limit, si dhe afatet e realizimit të kontratave.

7. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë do të jetë përfituesi i mallrave/shërbimeve objekt prokurimi.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi